



Pranimi / Dostava Prilpjen / Predaja Received / Delivery	15. 07. 2022	vite god year
Organ / Ujesta Organ / Jednica Org / Unit	SPANSIJK	
Id Prof Id Prof Prof No	4457/2022	
Shtypja Prilog Appendix		
Sasia Kolicina Quantity		116



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.582/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1963/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.582/2021 të datës 22.06.2021 të parashtruar nga ankuesi përmes përfaqësuesit, Avokatit me adresë: kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Shfuqizohet Vendimi i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë i datës 25.05.2021 me numër protokolli:4497.

II. Obligohet Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë ta *rishqyrtojë* lëndën e ankuesit

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit sipas shkresave të lëndës i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Sekretari i Përgjithshëm me datë 27.04.2021 ka kërkuar inicimin e procedurës disiplinore me pretendimet se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës, ndërsa Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 25.05.2022 ka nxjerrë vendimin me numër protokolli: 4494 duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil". Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisioni Disiplinor, në pajtim me dispozita ligjore në fuqi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me datë 22.06.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 28.06.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Më datë 06.07.2021 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka dërguar përgjigjen në ankesë me dosjen e bashkangjitur të lëndës e cila është protokolluar me numër 3471/2021.

Anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.06.2021 i kishte shkarkuar Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa, Këshilli e ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 10.06.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1963/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 05.08.2021 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 22.06.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 22.06.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.15/33 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 28.02.2018; E-mailin e datës 16.03.2016 dërguar nga _____ për _____ me shkresat e bashkangjitura dhe korrespondencën prej 19 faqesh; Kërkesën e datës 27.04.2021 me numër prot:3627; Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës me numër A.A.nr.2/21 të datës 14.01.2021; E-mailin e datës 09.10.2020 dërguar nga _____ për ankuesin; Autorizimin e datës 25.05.2021; kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.06.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 05.07.2021 me numër:2585-2/21 e pranuar në Këshill me datë 06.07.2021 me të gjitha shkresat e lëndës; Vendimi i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i datës 25.05.2021 me numër protokolli:4497; Aktgjykimit A.nr.1963/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Njoftimin e datës 05.08.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka vërtetuar se ekziston baza ligjore që lënda e ankuesit të kthehet në *rishqyrtim*, tek Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, se Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër protokoll: 4494 të datës 25.05.2021 ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës, aplikimin e gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër protokoll: 4494 të datës 25.05.2021 ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Largimi nga Shërbimi Civil" për shkak të konstatimit se i njëjti ka bërë shkelje të rënda të detyrave, ndërsa në arsyetimin e të njëjtit vendim specifikohet se ankuesi sipas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm për inicimin e procedurës disiplinore është përgjegjës për shkeljet gjatë periudhës kohore të vitit 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 87 paragrafi 1 i cili përcakton se: "*Nëpunësi civil shkarkohet nga shërbimi civil për shkak të performancës dhe rezultateve të dobëta, shkeljes së kodit të mirësjelljes dhe shkeljes së ligjit, i cili ka rezultuar me veprë penale, siç është përcaktuar me këtë ligj.*", si dhe neni 66 paragrafi 1 dhe 2, i të njëjtit ligj cilët përcaktojnë se: "*1.Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor*" si dhe "*2. Shkeljet e detyrave të punës ndahen në: shkelje të lehta dhe shkelje të rënda – serioze të cilat do të rregullohen me akt nënligjor*" si dhe dispozitat e Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10i cili përcaktojnë se: "...*Shkelje të rënda-serioze konsiderohen: shkelja e detyrave të punës që kanë pasojat për palën dhe organin shtetëror*", si dhe neni 8 paragrafi 1, nënparagrafët 1.1; 1.2, 1.3; 1.4 dhe 1.5 i të njëjtës rregulloreje të cilët përcaktojnë se: "*Për shkelje të rënda-serioze të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregulloreje, nëpunësit civil, mund t'i shqiptohen këto masa disiplinore: 1.1 pezullimi parandalues me pagesë deri në (3) muaj në pritje të një hetimi, i cili duhet të propozohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe miratohet nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion; 1.2 pezullimi i ushtrimit të detyrave dhe ndalimi i 1/3 së rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; 1.3 largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor; 1.4 ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension; dhe 1.5 pensionim i parakohshëm i nëpunësve civil, të cilëve u kanë mbetur edhe dy (2) vjet deri në datën e pensionimit*".

Po ashtu edhe me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik neni 45 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.5 ku përcaktohet se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit" si dhe nenin 46 paragrafi 1, 2 dhe 3 nën paragrafët nga 3.1 deri tek 3.11 ku përcaktohet se: "Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; "3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë" ndërsa në kuptim të natyrës së shkeljes së detyrave të punës neni 47 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 ka përcaktuar këto masa disiplinore: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit vlerëson se masa disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës" e cila i është shqiptuar ankuesit edhe sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, është masa më e rëndë disiplinore që shqiptohet në Shërbimin civil ndaj Nëpunësve Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 25.05.2021 dhe ka gjetur se arsyetimi i dhënë në këtë vendim është mbështetur në konstatimet e dhëna në preambulën e të njëjtit duke u mbështetur bazën ligjore, respektivisht, në nenin 45, 46, 48 dhe 49 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 8, 10, 11, 12 dhe 13 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, si dhe nenin 97 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa me këtë rast Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të arsyetojë mjaftueshëm vendimin, siç përcaktohet me nenin 48 paragrafi dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative : "Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij", ngase Komisioni Disiplinor me

rastin e nxjerrjes se vendimit të datës 25.05.2021 nuk ka arritur të arsyetojë se cili veprim apo mosveprim i ankuesit paraqet mos përmbushje të detyrave të punës apo shkeljeve të detyrave të punës ne rastin konkret, ngase neni 46 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përcakton edhe shkeljet e rënda sikurse edhe shkeljet e lehta , po ashtu në secilin rrethanë Komisioni Disiplinor duhet ta ketë pasur parasysh se për periudhën kohore në të cilën e kanë shpallur përgjegjës ankuesin kanë qenë të aplikuara dy (2) ligje, respektivisht nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit Nr. Ref.:AGJ 1583/20 të Gjykatës Kushtetuese është në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa inicimin e procedurës disiplinore nuk e kanë rregulluar njësoj të dyja ligjet, ndërsa ligji material çdo herë është i aplikueshëm vetëm në kohën e kryerjes së supozuar të shkeljes disiplinore dhe mbi këtë bazë Kolegji ka vendosur që të shfuqizojë vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 25.05.2021.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, thekson faktin se në pjesën e arsytimit të vendimit, Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të përmbushë mandatin ligjorë plotësisht dhe se për secilën shkelje të pretenduar është dashur të konstatojë saktë se në cilën përkufizim të dispozitave ligjore të shkeljeve të rënda të detyrave të punës hynë, po ashtu duhet ta ketë pasur parasysh se një veprim apo mos veprim në të njëjtën kohë nuk mund të cilësohet edhe shkelje e lehtë edhe e rëndë disiplinore, dhe po ashtu nëse Komisioni Disiplinor sipas përcaktimeve të bazës ligjore si në preambulë të vendimit e cilëson se ankuesi ka kryer shkelje të lehtë nuk mundet t'i shqiptojë masën më të rëndë disiplinor apo anasjelltas sikurse i referohet nenit 48 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik në mënyrë të përgjithësuar.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave mbi bazën e shkresave të lëndës si dhe te gjeturave të pasqyruara në arsyetimin e këtij vendimi, për shkak të metave të tij ligjore e ka pasur të pamundur të lëshohet në shqyrtimin thelbësor të rastit nëse ankuesi ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës apo nëse masa e shqiptuar disiplinore ka qenë në proporcion me shkeljen e supozuar, dhe mbi këtë bazë konstaton se ekziston bazë e mjaftueshme ligjore dhe të gjetura e fakte të provueshme se lënda e ankuesit duhet të kthehet në ri-shqyrtimi, njëherit Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative dhe me rastin e ri-shqyrtimit të lëndës, vërejtjet e dhëna në këtë vendim duhet t'i marrë parasysh me qëllim të zbatimit të drejtë të ligjit material, që arsyetimit i vendimit të jetë në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe masa e shqiptuar disiplinore duhet të jetë në proporcion me konstatimin eventual të shkeljes së supozuar.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”,* dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.582/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;;
- Arkivit të KPMSHCK-së

